

RREGULLORE E UFSH

PËR AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore synon të përcaktojë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen nga UFSH dhe strukturat përgjegjëse për akreditimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët farmacistë.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003 ‘Për Urdhrin e Farmacistëve në republikëne Shqipërisë’, Statutin e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë si dhe VKM Nr. 788, datë 22.09.2015 “Për Përcaktimin e Kritereve, Standardeve dhe Procedurave të Procesit të Akreditimit të Aktiviteteve të Edukimit të Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë”, VKM Nr. 394, datë 27.6.2018 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin të Standardeve, të Kritereve the Procedurave të Akreditimit të Ofruesve të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë””, VKM Nr. 440, datë 17.5.2017 “Për Përcaktimin e Standardeve, të Kritereve dhe Procedurave të Akreditimit të Ofruesve të Aktiviteteve të Edukimit të Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë profesionistët farmacistë anëtarë të UFSH-së që ndjekin aktivitetet e edukimit në vazhdim si dhe nga strukturat përgjegjëse të ngritura pranë UFSH-së.

Neni 4

Aktivitetet e edukimit në vazhdim organizohen nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të njohurive të profesionistëve farmacistë.

Neni 5

Në aktivitetet e edukimit në vazhdim të organizuar nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, janë të lirë të marrin pjesë të gjithë profesionistët farmacistë.

Neni 6

Aktivitetet akreditohen nga Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, në përputhje me këtë rregullore si dhe me VKM Nr. 788, datë 22.09.2015 “Për Përcaktimin e Kritereve, Standardeve dhe Procedurave të Procesit të Akreditimit të Aktiviteteve të Edukimit të Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë”, VKM Nr. 394, datë 27.6.2018 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin të Standardeve, të Kritereve the Procedurave të Akreditimit të Ofruesve të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë””, si dhe VKM Nr. 440, datë 17.5.2017 “Për Përcaktimin e Standardeve, të Kritereve dhe Procedurave të Akreditimit të Ofruesve të Aktiviteteve të Edukimit të Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë”.

Neni 7

Regjistrimi i pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit në një aktivitet duhet të regjistrohen në vendin dhe kohën e përcaktuar. Regjistrimi i pjesëmarrësve mund të jetë me numër të kufizuar dhe ky informacion do të bëhet i ditur në njoftimin e aktivitetit.

Në rastet e aktivitetit me numër të kufizuar regjistrimi i pjesëmarrësve mund të kryhet edhe kohë më parë dhe jo ditën e aktivitetit. Kjo do të bëhet e ditur në njoftimin për aktivitetin.

Pagesa e regjistrimit do të jetë e diferencuar për anëtarët dhe jo anëtarët e UFSH.

Regjistrimi do të kryhet personalisht. Nuk do të pranohen regjistrimet kolektive apo nga persona të tjerë. Në rastet kur aktiviteti është me numër të kufizuar pjesëmarrësish dhe numri i pjesëmarrësve është plotësuar, ndërpritet procesi i regjistrimit.

Në rastin kur regjistrimi kryhet në ditën dhe vendin e aktivitetit, atëherë regjistrimi do të zhvillohet duke respektuar kohën e përcaktuar. Nuk pranohet dhe refuzohet çdo tentative për regjistrimin e personave jo te pranishëm.

Neni 8

Aktiviteti mund të zhvillohet në një apo disa salla paralele sipas madhësisë dhe specialiteteve të përfshira. Aktiviteti mund të jetë i ndare në disa sesione me pushime të ndërmjetme. Te gjithë profesionistët duhet të ndjekin në mënyre aktive të gjitha sesionet për tu pajisur me dokumentin e pjesëmarrjes dhe kreditet përkatëse.

Për aktivitetet të llojit Konferencë do të shpërndahen materiale ose libër abstrakti ku pasqyrohet përmbajtja dhe tematikave e detajuar. Në përfundim të aktivitetit Konferencë çdo profesionist farmacist i regjistruar do të pajiset me certifikatën e pjesëmarrjes ku janë të shënuara edhe piket e kreditit.

Cdo profesionist përfiton kredit në varësi të orëve që merr pjesë. Certifikata e pjesëmarrjes do të tërhiqet personalisht nga profesionisti farmacist dhe jo nga të tjerë.

Tarifa e regjistrimit është e parikthyeshme për të gjithë profesionistët të cilëve do të refuzohet pajisja me certifikate nga mos respektimi i kësaj rregullore.

Neni 9

Procesi i akreditimit të aktiviteteve

Procesi i akreditimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim bëhet nga UFSH jo më vonë se 7 ditë pune nga data e planifikuar për zbatimin e tij.

Për çdo aktivitet të edukimit në vazhdim bëhet një procedurë aplikimi e veçantë.

Cdo aktivitet i nënshtrohet procesit të vlerësimit nga Komiteti Shkencor i ngritur pranë UFSH.

Neni 10

Struktura e organeve përgjegjëse për procesin e akreditimit të aktiviteteve

Organet përgjegjëse për akreditimin e aktiviteteve janë:

1. Komiteti Shkencor, i përbërë nga 3 persona;
2. Koordinator shkencor;
3. Një profesionist kompetent për edukimin në vazhdim;
4. Një person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe informacionit.

Neni 11

Komiteti shkencor

Komiteti shkencor, bën miratimin e planit të aktiviteteve, përfshirë programet dhe lektorë.

Komiteti Shkencor bën vlerësimin e temave të aktiviteteve.

Komiteti Shkencor vendos nëse aktiviteti akreditohet ose jo dhe përcakton numrin e krediteve për aktivitetin që do të akreditohet, në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 788, datë 22.09.2015 “Për Përcaktimin e Kriterëve, Standardeve dhe Procedurave të Procesit të Akreditimit të Aktiviteteve të Edukimit të Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë”

Neni 12

Koordinatori shkencor është përgjegjës për konceptimin dhe planifikimin e aktiviteteve.

Neni 13

Personi përgjegjës për edukimin në vazhdim, pranë UFSH-së, do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe sigurimin e mbarëvajtjes së aktiviteteve.

Neni 14

Person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe informacionit është përgjegjës për arkivimin e të gjitha dosjeve të aplikimit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të akredituara nga UFSH.

Neni 15

Caktimi i ekspertëve vlerësues

UFSH mund të ngarkojë dhe ekspertë të pavarur të fushës, për të kryer vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave që do të përdoren në aktivitet dhe për përputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve. Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti/ekspertët mund të sugjerojnë se cilat tema duhen konsideruar ose jo në llogaritjen e krediteve.

Neni 16

Aktivitetet, të cilat akreditohen, si dhe kreditet përkatëse të tyre, u bëhen të njohura farmacistëve dhe publikohen në faqen e internetit të UFSH-së.

Neni 17

UFSH duhet të njoftojë QKEV në 3 (tri) ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij.

Neni 18

QKEV-ja ka të drejtë të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim, të akredituar për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara.

Neni 19

Pas përfundimit të aktivitetit, UFSH duhet të dorëzojë pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet, brenda 30 ditëve nga përfundimi i aktiviteti.

Neni 20

UFSH organizon aktivitete të pavarura nga interesat tregtare.

UFSH duhet të menaxhojë, në mënyrë të përshtatshme, mbështetjen (financimin, fondet) tregtare. UFSH duhet ta mbajë të ndarë promovimin nga pjesa edukative e aktivitetit.

UFSH duhet të promovojë, në mënyrë aktive, përmirësime në shërbimin shëndetësor dhe jo interesat tregtare të ofruesve dhe/ose financuesve të aktivitetit.

E gjithë mbështetja financiare për aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të menaxhohet vetëm nëpërmjet UFSH.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë

Miraturar me vendimin Nr. 1, datë 23.12.2019, të Këshillit Kombëtar të UFSH.